

**Prishtinë: 31/ 05/2007**

**Kodi i ZRrE-së: D\_52\_2007**

**Nr. i Referencës: ERO/CPD\_R\_17\_05\_07**

### ***Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji***

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Ankesën e bërë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) të Zyrës së Rregullatorit për Energji sipas nenit 14.1 të Rregullës mbi procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të regjistruar me 24.05.2007 me numër regjistrimi 59/05 2007;
4. Procesin e KEK-ut (Distribucioni i Prizrenit) – Ndërprerja e Furnizimit me Energji Elektrike me numër 00224 të datës 08.07.2004;
5. Procesin e KEK-ut Shërbimi i Kontrollës – Distribucioni i Prizrenit me numër 0000012 të datës 13.09.2004;
6. Faturës Nr. 290/2004 Departamenti i Shitjes – Sektori i Faturimit (Distrikti i Prizrenit);
7. Urdhër Lejimit / Ngarkimit nga KEK-u me datë 01.10.2004;
8. Njoftimit të KEK-ut Distribucioni i Prizrenit për shumën e ngarkuar;
9. Protokolit mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik të Shërbimit të Bazhdarimit;
10. Procesverbalin për kontrollimin e instalimit elektrik të datës 21.11.2005;
11. Dëshminë e KEK-ut Distribucioni i Prizrenit për Kontestimin e harxhimit të paautorizuar të datës 07.11.2006;
12. Përgjigjen e KEK-ut të datës 15.05.2007;
13. Transaksionet e konsumatorit (kartela e konsumatorit);
14. Dëftesën e pagesës me datë 24.05.2007;
15. Nenin 19, nenin 19.1 përkatësisht 19.5 a) të Rregullit mbi Shkycjet dhe Rikycjet e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë Elektrike;
16. Neni 18 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

## Në Seancën e mbajtur me 31 Maj 2007 Bordi i ZRRE-së lëshon këtë:

### VENDIM

1. Me të cilin **Pjesërisht miratohet** ankesa e konsumatorit “EUROPA”-ËMBËLTORE, njëkohësisht ZRRE-ja kërkon nga KEK SH.A-ja që konsumatorin e lartpërmendur **të mos e shkyç nga furnizimi me energji elektrike**, derisa të vendoset lënda nga Zyra e Rregullatorit për Energji.
2. Obligohet KEK-u **të dorëzoj tek ZRRE-ja dokumente dhe informata shtesë si në paragrafin 8 të këtij Vendimi.**

### Arsyetim

1. Sipas urdhër lejimit / ngarkimit të datës 01.10.2004 konsumatori “**EUROPA**” **ËMBËLTORE** është ngarkuar me harxhim të paautorizuar në bazë të procesverbalit të shërbimit të kontrollës të KEK Sh.A-së numër 0000012 të datës 13.09.2004. E njëjta shumë e ngarkesës financiare iu është hequr nga kartela e konsumatorit me datë 07.11.2006 kurse shumë e njëjtë e ngarkesës financiare iu është regjistruar në kartelë me datën 16.05.2007 (transaksionet e konsumatorit).
2. Konsumatori ka bërë ankesë me datë 28.10.2006 në KEK Divizionin e Furnizimit – Distrikti Prizren në lidhje me shumën e ngarkuar (Harxhim i Paautorizuar) sipas procesverbalit të shërbimit të kontrollës nr. 0000012.
3. KEK-u me datë 15.05.2007 iu ka përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar konsumatorin lidhur me Harxhimin e Paautorizuar, në arsyetimin se ngarkesa lidhur me Harxhimin e Paautorizuar është bërë sipas procesverbalit të Shërbimit të Kontrollit Nr. 0000012 të datës 13.09.2004, dhe se ky procesverbal është përpiluar në bazë të raportit të shërbimit të kalibrimit (bazhdarimit) në të cilën është konstatuar se njehsori është i keqpërdorur.
4. Konsumatori ka ushtruar ankesë ndaj përgjegjës së KEK-ut në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 24.05.2007 e me numër regjistrimi 69/05 2007, ku ka kërkuar që mos të shkyçet nga rrjeti elektrik deri sa të vendoset lënda nga ZRrE-ja.
5. Në bazë të nenit 19.5 të Rregullit mbi Shkyçjet dhe Rikyçjet e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë Elektrike deri sa të bëhet rishikimi dhe vendosja e lëndës nga ZRrE-ja, nga konsumatori është kërkuar që të paguajë pjesën e borxhit të pakontestuar. Në bazë të kësaj konsumatori ka paguar pjesën e faturës që është e pakontestuar siç mund të shihet edhe në kartelën e konsumatorit.
6. Bazuar në nenin 19.1 të Rregullit mbi Shkyçje dhe Rikyçje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, KEK Sh.A. nuk do të shkyç konsumatorin deri sa të kryhet hetimi në lidhje me kundërshtimin e tij, pasi kushtet e Nenit 19.5 janë plotësuar.
7. Vendimi për mos-shkyçje vendoset si pasojë:

- a) E paqartësisë së procesverbalit të lëshuar me logon e KEK-ut por të panënshkruar nga personat përgjegjës të KEK-ut;
  - b) E mos-dorëzimit konsumatorit llogaritja e qartë e shumës me të cilën ngarkohet dhe e njëjta ngarkesë është kontestuar dhe larguar nga KEK-u e pastaj e rikthyer nga vet KEK-u;
  - c) Se procedura e udhëhequr e konstatimit të shpenzimit të pa autorizuar është tërësisht e gabuar dhe jo-transparente (mungojnë konstatimet e qarta për gjendjen e njehsorit si dhe procesverbali i njehsorit që përkohësisht është i vendosur meqë njehsori i konsumatorit është dërguar në laboratorin e kalibrimit).
8. Nga KEK-u kërkohet që në afatin prej 15 ditë nga dita e lëshimit të këtij Vendimi të dërgoj tek ZRrE-ja evidenca dhe fakte shtesë që dëshmojnë të kundërtën nga sa u tha në paragrafin 7 të këtij Vendimi.
9. Pas dorëzimi të informatave Bordi i ZRRE do të vlerësoj çështjen e harxhimit të paautorizuar.

***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjyqin Kompetent të Prishtinës, brenda **katërmbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRrE-së:

---

Ali Hamiti, Kryesues

---

Naim Bejtullahu, Anëtar

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Merita Kostari, Anëtare

---

Nysret Avdiu, Anëtar

